


Video-konferenca

Pyetje dhe përgjigje vijuese



Projekti i Sigurisë së Transmetimit Rajonal të Beverly

Pyetjet e mëposhtme janë kopjuar fjalë për fjalë nga biseda gjatë video-konferencës dhe janë ato që Shoqëria nuk mundi t'i merrte përpara se të përfundonte video-konferenca.

Pyetja: Ende nuk e kam të qartë se pse u përjashtua si mundësi pikërisht linja përgjatë MBTA. A mund të jeni më i/e qartë? Është thjesht një çështje kostoje apo është e pamundur nga aspekti fizik/teknik? Ju iu referuat çështjeve të paqarta MBTA. A mund të jeni më i/e qartë?

Përgjigjja: Shoqëria zbuloi se ndërtimi në Sipërfaqen e Shfrytëzimit të Tokës për Ndërtim (ROW) MBTA ishte i pamundur për disa arsye:

- **Hapësira e pamjaftueshme:** Pengesa kryesore për përdorimin e MBTA ROW është mungesa e hapësirës. Ky është një funksion i disa faktorëve, duke përfshirë gjerësinë e ROW; dendësia e infrastrukturës ekzistuese mbitokësore dhe nëntokësore tashmë të pranishme në atë ROW; përmasat e sistemit të ri të kanalit të pushtave dhe pajisjeve të rënda, duke përfshirë vinçat, të nevojshëm për ndërtimin e tij; dhe gjerësia e "zonës së ndikimit" të MBTA brenda së cilës është një zonë e mbrojtur për sigurimin e qëndrueshmërisë së binarëve të saj hekurudhor.
- **Kufizimet e Drejtorisë MBTA:** Për të shmangur ndërhyrjet në operacionet e saj hekurudhore, MBTA kufizon orët e punës në ndërtim në një hapësirë 4-orëshe midis orës 1 deri në 5 të mëngjesit. Kufizimi i punës në orët e para të mëngjesit do të ndikonte jashtëzakonisht tek fqinjët ngjitur, i cili përfshin një lagje banimi të së Drejtës Mjedisore të vendosur përgjatë anës veriore të ROW; dhe do të zgjaste ndjeshëm kohëzgjatjen e projektit nga tre deri në katër vjet, gjë që nga ana tjetër do të rriste ndikimet dhe kostot shoqëruese. MBTA e a lejuar Shoqërinë të kryejë riparimet e fundit në kabullin ekzistues; megjithatë, kjo ishte thjesht një masë e përkohshme emergjente që MBTA nuk do ta vazhdonte në punime rutinë ndërtimore, si instalimi i kabullit të ri.
- **Siguria:** Për të siguruar që klientët të vazhdojnë të shërbehen në mënyrë të sigurt, kabulli ekzistues duhet të mbetet në vend dhe në shërbim ndërsa Shoqëria instalon kabllon e re zëvendësuese. Rrjedhimisht, Shoqëria nuk mund të heqë kabullin ekzistues nga ROW dhe të instalojë kabullin e riun në vend të tij.

Pyetja: Hyra me vonesë, kështu që ju kërkoj falje nëse kjo çështje është adresuar. Pse u bë ndryshimi nga sipërfaqja e shfrytëzimit të tokës për ndërtim për telat mbi tokë? Pse të mos ndiqet e njëjta rrugë me kabullin nëntokësor?

Përgjigjja: Shoqëria kishte specifikuar arsyen pse është e pamundur të përdoret ROW e MBTA. Këto arsye përfshijnë fizibilitetin inxhinierik, ndikimin në zonat e banuara dhe komerciale, shmangien e detyrimit për të fituar të drejta pronësie private, sigurinë operacionale dhe ndërtimore, besueshmërinë, aksesin dhe ndikimet sociale dhe mjedisore. EFSB ra dakord dhe zbuloi se linja e propozuar ishte alternativa më e mirë në krahasim me alternativat e tjera, duke përfshirë ROW e MBTA.

Pyetja: Pse taksapaguesit e Beverly janë tarifuar për riasfaltimin për një projekt të National Grid për të gjithë Cape Ann. Ne kemi gjithashtu tarifa dhe taksa më të larta të National Grid?

Përgjigjja: Kjo nuk është e vërtetë. Për rrugët e trazuara nga ndërtimi i projektit, National Grid do të restaurojë nënsipërfaqen e rrugës sipas specifikimeve të Bashkisë dhe do të ndërtojë një sipërfaqe të asfaltuar të përkohshme që do të zgjasë derisa Bashkia t'i riparojë për një kohë të gjatë ato rrugë. Sipas Memorandumit të Marrëveshjes (MOA) ndërmjet qytetit dhe shoqërisë, Bashkia (ose kontraktorët e saj) do të kryejnë punimet e riasfaltimit dhe Shoqëria do të paguajë për të. Arsyeja për këtë aranzhim është se Bashkia shprehu dëshirën për të riasfaltuar vetë rrugët, sepse kishte kosto më të ulëta për njësi dhe, për rrjedhojë, mund të rregullonte një numër më të madh të rrugëve për koston që shoqëria vlerësonte për riasfaltimin.

Pyetja: A ka dy linja kabllore (tepricë) që shërbejnë Cape Ann në veri të nënstacionit të East Beverly? Nëse po, a gjenden mbi tokë apo nën tokë?

Përgjigjja: Dy burimet 115 kV (M-191 dhe N-192) ndalojnë në nënstacionin East Beverly. Dy qarqet 115 kV në nënstacion reduktohen në 34 kV dhe 23 kV, të cilat janë burimet që furnizojnë zonën e Cape Ann. Linjat 34kV dhe 23kV janë nëntokë.

Pyetja: Kur i referoheni riasfaltimit, a përfshihen heqjen e trotuareve dhe të pemëve të reja?

Përgjigjja: Për sqarim, në përputhje me Memorandumin e Marrëveshjes mes qytetit dhe shoqërisë, Bashkia do të kryejë riasfaltimin përfundimtar të rrugëve. Në lidhje me trotuaret, National Grid ra dakord të zëvendësojë çdo pjesë të trotuarit që duhet të hiqet për instalimin e pusetave dhe/ose të linjës së kanalit ose gjatë heqjes së kabllave. Për më tepër, Shoqëria ra dakord të zëvendësojë këto trotuare sipas standardeve të Bashkisë dhe me të njëjtat materiale si ato ekzistuese. Nëse gjatë ndërtimit kërkohet heqja e pemëve, National Grid u angazhua të konsultohet paraprakisht me Pemëtarin e Bashkisë, të respektojë të gjitha ligjet e zbatueshme të shtetit dhe urdhëresat e bashkisë dhe të zëvendësojë pemët e hequra në përputhje me politikën e zëvendësimit të pemëve të Beverly -- d.m.th. , çdo centimetër në kaliper që hiqet zëvendësohet me mbjelljen e pemëve në vende të përcaktuara nga Pemëtari i Bashkisë dhe çdo pemë e sapo mbjellë duhet të garantohet për dy vjet pas mbjelljes. Për më tepër, çdo prerje e kërkuar e rrënjëve të pemëve mund të kryhet vetëm pas konsultimit me Pemëtarin e Bashkisë. Pemët që i nënshtrohen prerjes me rrënjë do të garantohen nga kontraktori për të paktën një vit pas prerjes me rrënjë dhe do të zëvendësohen në përputhje me politikën e bashkisë nëse urdhërohet nga Pemëtari i Bashkisë.

Pyetja: Si do të bëhet e disponueshme kopja e regjistruar e këtij uebinari? Pyetja: A mund të jeni më të qartë në lidhje me datën e fillimit të këtij projekti?

Përgjigjja: Po. Një kopje e këtij uebinari është i disponueshëm në faqen e internetit të projektit, <https://www.beverlyregionaltransmissionreliabilityproject.com/>. Prezantimi nga ky uebinar është gjithashtu i disponueshëm në faqen e internetit të projektit, <https://www.beverlyregionaltransmissionreliabilityproject.com/project-overview>.

Pyetja: A mund të jeni më të qartë në lidhje me datën e fillimit të këtij projekti?

Përgjigjja: Shoqëria në Salem pret të fillojë ndërtimin në stacionin e Waite Street në dhjetor. Data e fillimit në Beverly nuk dihet për momentin sepse Shoqëria duhet të marrë akoma lejen e ndërtimit për kabullin nga Këshilli Bashkiak. Shoqëria synon ta paraqesë petitionin në janar ose rreth janarit 2022. Shoqëria është e përgatitur të fillojë ndërtimin pasi të miratohet dhënia e lejes së ndërtimit. Përditësimet mbi gjendjen e projektit në Beverly do të jenë të disponueshme në faqen e internetit të projektit ose me anë të regjistrimit në buletin tonë në <https://www.beverlyregionaltransmissionreliabilityproject.com/>.

Pyetja: U shkëputa - më falni... pyetja ime është -- a është regjistruar ky takim dhe si ta ndajmë atë me fqinjët tanë?

Përgjigjja: Po. Një kopje e këtij uebinari është i disponueshëm në faqen e internetit të projektit, <https://www.beverlyregionaltransmissionreliabilityproject.com/>. Prezantimi nga ky uebinar është gjithashtu i disponueshëm në faqen e internetit të projektit, <https://www.beverlyregionaltransmissionreliabilityproject.com/project-overview>.

Pyetja: A është National Grid i gatshëm të krijojë një fond për të kompensuar rastet e mundshme të kancerit në të ardhmen bazuar në analizën e Dr. Bailey?

Përgjigjja: Dëshmia e Dr. Bailey nuk mbështet rezultatin se ekziston një lidhje shkakësore midis projektit dhe shkallës së kancerit. Përkundrazi, Dr. Bailey shpjegoi se hulumtimet më aktuale nuk tregojnë asnjë lidhje ndërmjet MF dhe leukemisë tek fëmijët. Gjithashtu, Organizata Botërore e Shëndetësisë nuk ka gjetur "asnjë të dhënë për të arritur në përfundimin se ekspozimi ndaj fushave elektromagnetike të nivelit të ulët është i dëmshëm për shëndetin e njeriut". Në mënyrë të ngjashme, Instituti Kombëtar i Kancerit në SHBA zbuloi se "Nuk ka prova të qëndrueshme për lidhje midis ndonjë burimi EMF jo-jonizues dhe kancerit". Vlerësimi më i fundit i kryer nga Komiteti Shkencor i Bashkimit Evropian për Rreziqet e Shëndetit në zhvillim dhe të sapo identifikuar (SCENIHR) arriti në një përfundim të ngjashëm. Informacioni për këto vlerësime shkencore mund të gjendet më poshtë.

Instituti Kombëtar i Kancerit në SHBA:: <https://www.cancer.gov/about-cancer/causes-prevention/risk/radiation/electromagnetic-fields-fact-sheet>

OBSH: <https://www.who.int/news-room/questions-and-answers/item/radiation-electromagnetic-fields>

SCENIHR: Efektet e mundshme shëndetësore të ekspozimit ndaj fushave elektromagnetike (EMF) (europa.eu) Përveç kësaj, EFSB miratoi projektin pas shqyrtimit të plotë të potencialeve për

ndikimet e EMF, duke gjetur se ndërtimi i projektit do të ishte në përputhje me politikat aktuale shëndetësore të Komonuelthit.

Pyetja: A do të hiqen dhe të vendosen nën tokë linjat aktuale të energjisë mbitokësore si pjesë e këtij projekti?

Përgjigjja: Jo. Ky projekt do të zëvendësojë një linjë të transmetimit elektrik nëntokësor dhe nuk do të ndikojë në asnjë ndryshim në linjat e transmetimit ose të shpërndarjes mbitokësore.

Pyetja: Si do të hyj dhe dal nga shtëpia ime gjatë ndërtimit? Po sikur puseta të jetë para shtëpisë sime?

Përgjigjja: Pasi të gërmohen kanalet, pllakat e çelikut do të vendosen sa më shpejt mbi vendet e gërmimit që kryqëzojnë rrugicat, duke lejuar që pronarët e shtëpive të hyjnë dhe të dalin nga rrugicat e tyre. Gardhi mbrojtës mund të përdoret gjatë ndërtimit dhe në disa raste mund të zgjerohet në trotuar dhe të bllokohet përkohësisht atë segment të trotuarit. Në këto raste do të vendoset sinjalistika dhe devijimet për këmbësorët. Për shkak se ky do të jetë një projekt linear, ndikimet do të jenë të përkohshme në çdo vend. Ne e pranojmë se ndërtimi krijon shqetësime dhe inkurajojmë pronarët fqinjë të na kontaktojnë në lidhje me çdo shqetësim që mund të keni përpara ose gjatë procesit të ndërtimit në (833)-238-4743 ose info@BeverlyRegionalTransmissionReliabilityProject.com

Pyetja: A do të ndiheshin rehat njerëzit në këtë panel që jetojnë në këtë linjë me familjen e tyre?

Përgjigjja: Po. Siç u përmend më lart, gjendja aktuale e njohurive konfirmon se nuk ka "asnjë të dhënë për të arritur në përfundimin se ekspozimi ndaj fushave elektromagnetike të nivelit të ulët është i dëmshëm për shëndetin e njeriut". Për sa i përket ndërtimit, e pranojmë se ky lloj ndërtimi mund të krijojë shqetësime për lagjet. Për shkak se ndërtimi do të vazhdojë poshtë rrugës, ndikimet në çdo vend do të jenë afatshkurtra. Do të bëjmë çdo përpjekje për t'i mbajtur pronarët e shtëpive të informuar në lidhje me oraret e ndërtimit, përparimin e punës sonë dhe hapat e ardhshëm. Mos hezitoni të na raportoni çdo shqetësim që keni gjatë procesit duke përdorur linjën telefonike (833) 238- 4743 ose me email info@BeverlyRegionalTransmissionReliabilityProject.com.

Pyetja: Çfarë do ta përcaktojë fillimin e ndërtimeve?

Përgjigjja: Faza e ndërtimit në Beverly varet pjesërisht nga koha e dorëzimit të peticionit nga Shoqëria për vendet në rrugë dhe shqyrtimi i këtij peticioni nga Këshilli Bashkiak. Nëse ky peticion refuzohet, Shoqëria do t'i dërgojë peticion EFEB, i cili do të vononte fillimin e ndërtimit. Gjatë kësaj kohe, ne po planifikojmë të vazhdojmë angazhimin me nëpunësit e zgjedhur dhe komunitetin në përgjithësi për t'u siguruar që do të vazhdojmë me angazhimin tonë për të trajtuar fushat ku ka shqetësime.

Shoqëria në Salem pret të fillojë ndërtimin në dhjetor. Për të marrë më shumë përditësime mbi gjendjen e projektit, mos ngurroni të regjistroheni në buletin tonë në adresën <https://www.beverlyregionaltransmissionreliabilityproject.com/>

Pyetja: Sapo mora me postë ftesën për video-konferencën. Nëse nuk do ta kisha vënë re, do të kisha humbur prezantimin. Kur janë dërguar ftesat?

Përgjigjja: Ftesat pritej të vinin në mes të javës së kaluar (java e 22/11). Për më tepër, që të bënim publike video-konferencën, më 22 nëntor, ne publikuam një reklamë gjysmë faqe në Salem News.

Për më tepër, ne dërguam ftesat për video-konferencën për nëpunësit e zgjedhur më 19 nëntor. Jemi mirënjohës për nivelin e ndërveprimit që kemi pasur me komunitetin gjatë video-konferencës. U bashkuan 78 anëtarë të komunitetit, duke përfshirë një numër nëpunësish të zgjedhur dhe drejtues të komunitetit.

Pyetja: A do të fillojë projekti në urën e Beverly Salem dhe a do të vazhdojë sipas afatit kohor? Pra, ndikimi në Cross Lane do të ishte rreth përfundimit të projektit?

Përgjigjja: Ka gjasa që ekuipet të fillojnë punën në vende të ndryshme në mënyrë që të përshpejtojnë procesin e ndërtimit. Për momentin nuk mund të themi se kur presim të fillojë ndërtimi në Cross Lane, pasi nuk ka një plan të caktuar ndërtimi. Pasi të caktohet plani, presim të ndajmë sekuencën e parashikuar të veprimtarisë së ndërtimit. Po ju bëjmë me dije se ekipi ynë i kontaktit do të jetë në komunitet, dhe do të shkojë në çdo shtëpi për të ofruar informacionin më të fundit për projektin përpara se të fillojë ndërtimi në një rrugë të caktuar. Ky informacion do të jetë gjithashtu i disponueshëm në faqen e internetit të projektit dhe do të shpërndahet përmes programit tonë të buletinit të emailit. Ndërkohë inkurajojmë palët e interesuara të regjistrohen në buletin tonë në <https://www.beverlyregionaltransmissionreliabilityproject.com/>.

Pyetja: A do të ishit i/e hapur për të rishikuar zgjidhje të tjera praktike për vendosjen e kabullit përgjatë ROW ekzistuese të MBTA? Unë mendoj se ka mundësi të tjera. Faleminderit.

Përgjigjja: Jo gjatë kësaj kohe. Përpara paraqitjes së aplikacionit të saj EFSB, Shoqëria punoi ngushtë me zyrën e Kryetarit të Bashkisë për të vlerësuar ROW e MBTA dhe për të identifikuar linjat e preferuara dhe alternative. Më pas, EFSB i rishikoi tërësisht ato linja, si dhe rishikoi përfundimin e Shoqërisë se nuk mund të kryhej ROW e MBTA. EFSB i kërkohet me ligj që të shqyrtojë "vendet e tjera të kantierit" për objektet e propozuara të energjisë. Për përmbushjen e këtij standardi, EFSB kërkon që aplikanti të vërtetojë se ka konsideruar një numër të arsyeshëm alternativash praktike të vendndodhjes/linjës. Në fund, EFSB zbuloi se linja e propozuar është alternativa më e mirë krahasuar me rrugën alternative në bazë të kostos balancuese, ndikimit mjedisor dhe sigurisë së furnizimit. Bordi gjithashtu ra dakord që nuk mund të kryhej ROW e MBTA.

Pyetja: Pse nuk jeni përpjekur të punoni me Bashkinë e Beverly për të gjetur një zgjidhje më të përshtatshme? Duket sikur po përpiqeni ta merrni këtë vendim pa miratimin e qytetarëve ose të Bashkisë.

Përgjigjja: Nuk është e vërtetë që National Grid nuk është përpjekur të punojë me Bashkinë. National Grid është konsultuar gjerësisht me Kryetarin e Bashkisë, stafin e tij dhe nëpunës të tjerë të qytetit, duke përfshirë Departamentin e Inxhinierisë që nga fillimi i vjeshtës 2019. Gjatë këtyre diskutimeve, Bashkia dha të dhëna të rëndësishme që rezultuan në zgjedhjen e rrugës së preferuar. Këto konsultime përfshinë negociata të gjata mbi kushtet e Memorandumit të Marrëveshjes që u nënshkrua nga Bashkia dhe Shoqëria, dhe që synonte zbutjen e ndikimeve të projektit mbi banorët dhe bizneset e qytetit.

Përveç konsultimit me Bashkinë dhe kërkesës për njoftim të EFSB, National Grid kontaktoi gjerësisht me komunitetin në Beverly dhe Salem. Ky kontakt përfshinte katër anketa në çdo shtëpi me linjë të plotë, me nga një anketë për çdo shtëpi të synuar të lagjes Goat Hill.

Gjatë vijueshmërisë së këtyre përpjekjeve u vizituan 2,815 shtëpi dhe u zhvilluan 399 biseda me njerëzit përgjatë dhe pranë linjës së projektit. Gjithashtu, ka pasur pesë konferenca publike/seanca dëgjimore për projektin. Për secilin nga këto evente, ju dërguan më shumë se 2000 ftesa fqinjëve tanë në Beverly dhe Salem. U vendosën gjithashtu reklama në Salem News si një mjet tjetër për të publikuar këto mundësi për të mësuar rreth projektit dhe për të mbledhur reagime nga komuniteti. Për më tepër, EFSB mbajti një seancë dëgjimore për komentet e vërejtura publikisht pasi Shoqëria paraqiti aplikimin e saj.

Pyetja: Nëse kabloja e tensionit të lartë furnizon me energji Manchester, Rockport dhe Gloucester, pse të mos kalohet kabulli nënujor direkt nga Salem deri në bregdet?

Përgjigjja: EFSB është e autorizuar të sigurojë që objektet energjetike të ndërtohen me koston më të ulët, duke balancuar gjithashtu ndikimet mjedisore dhe sigurinë. Zgjidhja për projektin nënujor ka të ngjarë të mos përmbushë asnjë nga këto standarde dhe nuk do të miratohet nga EFSB. Së pari, kostot e një projekti nënujor do të tejkalonin koston e instalimit të kabullit nën rrugët publike. Së dyti, ndikimet mjedisore ndaj burimeve nënujore dhe specieve detare do të tejkalojnë ndikimet relativisht të vogla mjedisore që lidhen me shqetësimet nga rrugët publike. Së fundi, një kabull nënujor është më pak i sigurt për shkak të kushteve dukshëm më të vështira të mirëmbajtjes që vështirësojnë aftësinë për të inspektuar sistemin kabllor që është gruposur drejtpërdrejt në lumë ose në shtratin e detit. Për më tepër, nëse kabloja nënujore dëmtohet ose nuk funksionon, koha e nevojshme për të riparuar qarkun kabllor do të zgjaste më shumë në krahasim me sistemin e pusetave dhe kanaleve.

Pyetja: Pra, mund të ndiqni ROW e MBTA, por zgjidhni të mos e përdorni?

Përgjigjja: Nuk është e vërtetë. Shoqëria ka shpjeguar arsyet e shumta pse përdorimi i ROW së MBTA nuk është një opsion i zbatueshëm. ROW e MBTA nuk ishte një nga disa linjat që është po aq e realizueshme. Përkundrazi, ROW e MBTA ROW është një linjë më e kushtueshme, më pak e sigurt, më pak e besueshme, më pak e ndërtueshme dhe më me ndikim.

Pyetja: Shkoni në çdo shtëpi në Lothrop St dhe na njoftoni të gjithëve kur do ta bëni këtë kontakt, që të qëndrojmë në shtëpi. Faleminderit

Përgjigjja: Ne do të vazhdojmë vizitat në çdo shtëpi në zonë përpara ndërtimit. Do të fillojë një raund në dy javët para ndërtimit (përafërsisht). Ndërkohë, mos ngurroni të regjistrohemi për buletin tonë në <https://www.beverlyregionaltransmissionreliabilityproject.com/>.

Pyetja: Pashë vendimin e ZOOM të EFSB dhe që Sec Theoharides shtoi lartësinë në të dy nënstacionet për t'i rezistuar ndryshimeve klimatike dhe më është thënë se kjo i shtoi projektit 100 milionë dollarë. Kjo do ta bënte këtë projekt të ketë vlerën e 200 milionë dollarësh. Gjithsesi, sa është kostoja shtesë për të tarifuar pagesit?

Përgjigjja: Aktualisht shoqëria po vlerëson opsionet për të mbrojtur të gjithë Nënstacionin #12 të Beverly - jo vetëm pajisjet e reja - nga ngritja e nivelit të detit. Do t'i paraqesim rezultatet e këtij

vlërësimi në EFSB në fillim të vitit 2022. Nuk presim që kostoja e ndonjë prej këtyre opsioneve të jetë rreth +100 milionë dollarë. Kostoja e këtyre përmirësimeve të nënstacionit do të mbulohet nga klientët tanë nëpërmjet faturave të tyre elektrike në momentin kur ato do të vihen në shërbim, e cila mund të realizohet disa vite pas përfundimit të projektit të linjës së transmetimit.

Pyetje: Si mund të garantoni sigurinë e pronarëve fqinjë të banesave në Beverly nga fushat elektromagnetike ku do të jetojnë për një kohë të gjatë? A ka shteti i Massachusetts ose qeveria federale udhëzime sigurie në lidhje me jetesën në afërsi të fushave elektromagnetike?

Përgjigjja: Siç u përmend më lart, gjendja aktuale e njohurive konfirmon se nuk ka "asnjë të dhënë për të arritur në përfundimin se ekspozimi ndaj fushave elektromagnetike të nivelit të ulët është i dëmshëm për shëndetin e njeriut". Ekspozimi ndaj fushave magnetike ndodh në të gjithë komunitetet tona në rrugë, shtëpi, shkolla dhe vende pune. Asnjë institucion shëndetësor apo shkencor kombëtar apo ndërkombëtar nuk ka përcaktuar se fushat magnetike kanë efekte negative në shëndetin publik. As qeveria federale dhe as shteti i Massachusetts nuk kanë zhvilluar udhëzime për ekspozimin ndaj fushave magnetike.

Pyetja: Pse MBTA do të pohonte se kërkon një distancë më të madhe se 6 m midis kabullit tuaj dhe infrastrukturës së tyre në ROW, por ju keni pohuar se kabulli është i sigurt brenda rrugëve të Beverly me më pak distancë midis kabullit suaj dhe infrastrukturës së Bashkisë tonë, dhe gjithashtu është e sigurt vendosja e kabullit tuaj, në disa raste, në trotuar përpara shtëpive më pak se 1.5 m nga pjesa e brendshme e një banese?

Përgjigjja: Drejtoria e Operacioneve Hekurudhore të MBTA krijon udhëzime për ndërtimin brenda ROW hekurudhore të MBTA dhe kërkon që të gjitha objektet e instaluar brenda një ROW hekurudhor aktiv të vendosen jashtë zonës së ndikimit të ngarkesës aktive të binarëve. Kjo zonë ndikimi shtrihet nga një pikë 2 m në anë horizontale nga vija qendrore e bazës së binarit në një pjerrësi prej 60 cm në anë horizontale deri në 30 cm në anë vertikale larg binarëve. Arsyeja për këtë kufizim është se gjurmimet brenda kësaj zone do të ekspozohen ndaj ngarkesave të rënda aktive nga trenat dhe mund të prishin shinat. Kjo kërkesë ka të bëjë me integritetin fizik të shtratit hekurudhor.

Pyetja: Tubacioni i rrjedhjes së ujit për të cilin po pyes është unik për këtë seksion të Lothrop St dhe është instaluar 20 vjet më parë për të parandaluar përmytjet në lagje që ndodhën në mot të keq. Tubacioni në thelb ndan rrjedhën e një përroi dhe ka parandaluar përmytjen që kur është instaluar. Dëmtimi i këtij tubacioni gjatë instalimit të linjave të transmetimit do të ishte një lajm jashtëzakonisht i keq për banorët.

Përgjigjja: Po ju bëjmë me dije i se tubi i kullimit që ju thoni se ndodhet përgjatë rrugës Lothrop është identifikuar dhe paraqitur në fletët tona të planit dhe profilit të ndërtimit. Për të shmangur dëmtimin e shërbimeve ekzistuese komunale, përpara se të kryhet ndonjë ndërtim, kontraktori ynë do të marrë masat për gjetjen e shërbimeve komunale në terren, duke përfshirë përdorimin e Radarit Depërtues në Tokë (GPR) për të verifikuar vendndodhjen e shërbimeve komunale nëntokësore përpara fillimit të punimeve të gjurmimit.

Për më tepër, çdo shërbim i ekspozuar gjatë gjurmimit do të mbështetet dhe mbrohet në mënyrë të përshtatshme gjatë ndërtimit në përputhje me kërkesat e pronarit të shërbimeve komunale.

Gjithashtu, kontraktori ynë do të koordinojë punimet tona të ndërtimit me Beverly DPW gjatë gjithë projektit dhe Bashkia do të ketë gjithashtu një inxhinier konsulent për të mbikëqyrur ndërtimin.

Pyetja: Cili ishte shkaku i defektit që rezultoi në humbjen e energjisë në kabullin* që u vu në punë kohët e fundit? [*kabullin]

Përgjigjja: Me kalimin e viteve, gazi u grumbullua brenda kabullit për shkak të vjetërsisë dhe përkeqësimit të kabullit. Si rezultat, ndodhi një defekt në vendin ku u grumbullua gazi duke nxjerrë jashtë funksionit sistemin kabllor. Ndërkohë që kabulli ishte jashtë shërbimit, u bënë gjurmime të shumta përgjatë ROW të hekurudhës së MBTA. Riparimet në sistemin kabllor në vendin e defektit dhe të gjurmimit u kryen për rikthimin e kabullit në gjendjen e tij normale.

Pyetja: Në EFSB 16- 02/DPU 16- 77, në f. 70, National Grid ra dakord për monitorimin e fushës magnetike para dhe pas ndërtimit dhe shmangien e ndërtimit nën trotuare me kërkesë të Needham. A do të binte dakord National Grid për masa të ngjashme në Beverly?

Përgjigjja: Po. National Grid pranon masë nivelet ekzistuese të fushave magnetike në vende përfaqësuese në rrugët e banesave dhe trotuaret përgjatë linjës përpara ndërtimit dhe pasi kabllot të jenë vënë në punë.

Për sqarim, vendimi i referuar i EFSB ishte një miratim i dhënë një projekti Eversource Energy, jo nga një projekt i National Grid. Vendimi i EFSB vë në dukje se Bashkia e Needham kërkoi monitorimin para dhe pas ndërtimit të fushave magnetike "për të konfirmuar saktësinë e niveleve të parashikuara dhe për të dhënë njoftim paraprak nëse nivelet e fushave magnetike tejkalojnë kufijtë e ekspozimit të sigurt në të ardhmen". fq. 67. Bordi shtetëror urdhëroi matjet para dhe pas ndërtimit "për njohjen e shqetësimeve të publikut për fushën magnetike në rastet e mëparshme", jo sepse ka gjetur ndonjë efekt aktual në shëndetin publik.

Për këtë projekt, raporti i Exponent, "Projekti i Sigurisë së Transmetimit Rajonal të Beverly - Vlerësimi i fushës magnetike të zhvendosjes së kabllorëve N-192", tregon se Shoqëria ka ndërmarrë hapa për të ulur nivelet e EMF:

Plani i projektit përfshin metoda të njohura për reduktimin e ekspozimit të fushës magnetike, të tilla si ndërtimi i kabllorëve nën tokë dhe me një distancë të vogël të ndarjes nga faza në fazë, në mënyrë që nivelet e fushës magnetike të ulen me shpejtësi me distancën nga kabllorët. Plani i kabullit rezulton në nivele të llogaritura të fushës magnetike për të gjitha konfigurimet e projektit, të cilat janë në nivele shumë më të ulëta të udhëzimeve si ICNIRP (2,000 mG) dhe ICES (9,040 mG) në të gjitha vendndodhjet, madje edhe në thellësinë minimale të groposjes. Nivelet e fushës magnetike do të ishin edhe më të ulëta në thellësi më të madha të groposjes. (fq. 8)

Përfundimi se plani i projektit nga National Grid ka minimizuar fushat magnetike u konfirmua në Vendimin Përfundimtar të EFSB.¹

¹ "NEP do të ndërtonte kabullin e ri kryesisht brenda rrugëve publike dhe me hapësira relativisht të afërta të përçuesve; këta faktorë do të siguronin njëkohësisht zbutje të konsiderueshme të fushave magnetike. Bazuar në planin dhe operacionin e Projektit, siç përshkruhet më sipër, Bordi shtetëror konstaton se ndikimet e fushës magnetike të Projektit do të reduktohen përgjatë linjës kryesore." Vendimi përfundimtar i EFSB, në 103.

National Grid ka besim se peticioni i saj drejtuar EFSB ka paraqitur vlerësime të arsyeshme dhe të sigurtatë fushave magnetike të Projektit dhe se matjet pas ndërtimit do të konfirmojnë se këto nivele të fushës magnetike janë shumë më poshtë standardeve aktuale ndërkombëtare për ekspozimin e njerëzve. Veçanërisht, fushat magnetike mund të anulohjnë njëra-tjetrën dhe Shoqëria planifikoi projektin në mënyrë që të optimizojë efektin e anulimit të fushës magnetike për kabullin zëvendësues.

Pyetja: Z. Bill Bailey përmend studimet që i referohen fushave të shkurtra të sigurta. Shumë shtëpi përgjatë linjës së propozuar të Beverly do të jenë të ekspozuara për një kohë të gjatë ndaj forcave elektromagnetike brenda fushave elektromagnetike afatgjatë. A mund të ofroni studime shkencore që sigurojnë që ekspozimi afatgjatë ndaj fushave elektromagnetike është i sigurt?

Përgjigjja: Pyetja keq-karakterizon shpjegimin e Dr. Bailey për slidet që ai prezantoi në video-konferencë. Ai tha se fushat magnetike të llogaritura nga projekti do të ishin shumë më poshtë standardeve të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Këto standarde u zhvilluan në bazë të vlerësimeve të hulumtimit mbi studimet e raportuara afatshkurtra dhe afatgjata të njerëzve dhe kafshëve; gjatë përcaktimit të kufijve u vunë re efekte e vetme negative në studimet afatshkurtra në nivele të larta të fushës dhe nuk u konfirmua asnjë efekt negativ i fushave magnetike në studimet afatgjata të epidemiologjisë tek njerëzit (ICNIRP 2010; ICES, 2019).

Ai prezantoi rezultatet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Kancerit në SHBA nga faqet e tyre të internetit që përcjellin vlerësimet e tyre se EMF nga sistemi ynë energjetik nuk duket se shkakton ose kontribuon në efekte negative shëndetësore tek të rriturit ose fëmijët (rrëshqitja 19). Në slide-in 20, ai përshkroi ecurinë e studimit mbi EMF dhe leukemisë tek fëmijët që është vlerësuar në mënyrë sasiore në analizën e grumbulluar të studimeve të epidemiologjisë tek njerëzit që përfshinë periudhën nga viti 1979 deri më sot. Ai shtoi rezultatet e analizës së fundit të grumbulluar të të dhënave nga 10 vitet e fundit të studimit që krahasuan ekspozimet e fushës magnetike të rreth 25,000 fëmijëve me leukemi me ato të afërsisht 31,000 kontrolleve pa leukemi nga Amoon et al. (2021) që:

Ndryshe nga analizat e mëparshme të mbledhura, ne nuk gjetëm rritje të rrezikut të leukemisë [mbi 0.4 μ T].

Si përfundim, rezultatet tona nuk tregojnë rritjen e rrezikut të vërejtur në analizat e mëparshme të mbledhura dhe, me kalimin e kohës, tregojnë një rënie të efektit në mungesë të lidhjes midis MF dhe leukemisë tek fëmijët. (është shtuar theksimi)

Ju lutemi referojuni raportit të Exponent "Statusi aktual i kërkimit mbi fushat elektrike dhe magnetike me frekuencë jashtëzakonisht të ulët dhe shëndetin 2014- 2018" për rezultate shpesh të kërkimit shëndetësor EMF.

Pyetja: Pas përfundimit të projektit cila është pritshmëria për mirëmbajtjen e vazhdueshme në linja? A do të bëhen lagjet tona zona të vazhdueshme të mirëmbajtjes me ndërprerje të trafikut, ndotje akustike dhe shqetësime të tjera në të ardhmen?

Përgjigjja: Po ju bëjmë me dije i se tubi i kullimit që ju thoni se ndodhet përgjatë rrugës Lothrop është identifikuar dhe paraqitur në fletët tona të planit dhe profilit të ndërtimit. Përpara se të kryhet ndonjë ndërtim, kontraktori ynë do të kryejë masat e gjetjes së shërbimeve në terren, duke përfshirë përdorimin e Radarit Depërtues në Tokë (GPR) për të verifikuar vendndodhjen e

shërbimeve nëntokësore përpara fillimit të punës së gjurmimit. Për më tepër, çdo shërbim i ekspozuar gjatë gjurmimit do të mbështetet dhe mbrohet në mënyrë të përshtatshme gjatë ndërtimit në përputhje me kërkesat e pronarit të shërbimeve komunale. Më tej, kontraktori ynë do të koordinojë punimet tona të ndërtimit me Beverly DPW gjatë gjithë projektit.

Pyetja: Sa para i tarifon MBTA National Grid që dy linjat e tyre aktuale të tensionit të lartë të kalojnë nëpër "sipërfaqen e shfrytëzimit të tokës për ndërtim" të hekurudhës midis nënstacionit River St dhe nënstacionit Boyle St?

Përgjigjja: Sipas marrëveshjes së vitit 1994, National Grid i paguan MBTA një tarifë vjetore prej rreth 11,631 dollarë për kabullin ekzistues N-192. Megjithatë bazuar në përvojën e fundit MBTA do të kërkonte tarifa dukshëm më të larta për të zënë një pjesë të ROW të MBTA.

Pyetja: Jepni një shembull specifik të një kabulli 115 kv në të njëjtën linjë si një linjë kombëtare gazi 12" ose më e madhe se 64 spi, përveç Webber Avenue?

Përgjigjja: Gjatë procesit të EFSB, Dr. Rome ngriti këtë dhe pyetje të ngjashme në lidhje me shqetësimet e tij në lidhje me afërsinë e kabullit të ri me linjat ekzistuese të gazit nën Webber Ave. Shoqëria iu përgjigj plotësisht këtyre pyetjeve dhe EFSB zbuloi në fund se "nuk kishte rreziqe të pazakonta sigurie nga operacioni i Kabullit të Ri" dhe se "masat e sigurisë mbrojtëse të vendosura për Kabullin e Ri do të minimizonin rrezikun që një aksident i lidhur me ndërtimin ose operacionin e tij mund të dëmtojë linjat e shpërndarjes së gazit përgjatë linjës kryesore." (Vendimi përfundimtar në 93.)

Më konkretisht, Shoqëria dëshmoi se kabulli i ri do të projektohet, ndërtohet dhe mirëmbahet në përputhje me praktikën e sigurta inxhinierike dhe të gjitha kodet e zbatueshme të sigurisë dhe praktikën më të mira. Shoqëria shpjegoi se seksioni 320B5 i Kodit Kombëtar të Sigurisë Elektrike përcakton një kërkesë minimale të ndarjes radiale 30 cm midis kanaleve elektrike nëntokësore dhe linjave të gazit. Për këtë projekt, Shoqëria planifikon të vendosë kabullin e ri në Webber Avenue mbi 6.4 m larg nga linja e gazit 60 psig, shumë më tepër se standardi minimal 30 cm. Gjithashtu, shoqëria vuri në dukje se kabulli ekzistues, i gruposur drejtpërdrejt (që do të hiqet) është tashmë i vendosur në mënyrë të konsiderueshme më afër linjave ekzistuese të shpërndarjes së gazit natyror përgjatë Weber Ave. Rrjedhimisht, projekti do të zvogëlonte çdo rrezik sigurie pasi do të ishte në një distancë më të madhe, i mbështjellë në një kanal betoni për kabullo nëntokësorë dhe do të ishte një kabullo dielektrike e fortë që ka funksionuar gjithmonë në përvojën e NEP.

Pyetja: Nëse bashkia e Beverly-t nuk bie dakord me propozimin aktual, a ka National Grid një plan rezervë?

Përgjigjja: EFSB miratoi projektin në fillim të tetorit. Bashkia kishte mundësinë të ndërhynte në atë proces, por zgjodhi të mos ndërhynte. Këshilli Bashkiak duhet të miratojë akoma peticionin e Shoqërisë për dhënien e lejes së ndërtimit, të cilat Shoqëria parashikon të dorëzojë në fillim të vitit të ardhshëm. Legjislacioni është i qartë sepse duke qenë se shërbimet komunale ofrojnë një shërbim publik, ato kanë të drejtë të ndërtojnë infrastrukturën brenda rrugëve publike. Si rrjedhojë, gjatë shqyrtimit të aplikimeve për dhënien e lejes së ndërtimit, këshillat bashkiakë janë dhe duhet të veprojnë si agjenci të Komonuelthit dhe jo si organe vendore. Duke pasur parasysh rëndësinë e projektit për sigurinë e sistemit elektrik, Shoqërinë shpreson që Këshilli Bashkiak do të miratojë peticionin e saj. Nëse Këshilli Bashkiak e refuzon peticionin për ndonjë arsye, Shoqëria do të

aplikojë në EFSB për një Certifikatë të Ndikimit Mjedisor dhe Interesit Publik, e cila, nëse jepet, do të kishte efektin ligjor të dhënies së GOL dhe çdo leje projekti shtesë të nevojshme për ndërtimin e projektit.

Pyetja: A do të publikohet lista e regjistrimeve për këtë uebinar?

Përgjigjja: Jo. Shoqëria nuk do të publikojë listën e regjistrimit për uebinarin sepse ajo përfshin adresat e emailit të njerëzve. Nuk mund të supozojmë se çdo pjesëmarrës dëshiron emrin dhe adresën e emailit. Nuk mund të supozojmë se çdo pjesëmarrës dëshiron që emri dhe adresa e tij e emailit të bëhen publike.

Pyetja: Cilat janë situatat e paparashikuara nëse nivelet e EMF janë më të larta se sa ishte parashikuar?

Përgjigjja: Eksperti i EMF së shoqërisë, Exponent, nuk e "parashikoi" nivelin e EMF, por, në vend të kësaj, i llogariti ato duke përdorur modele të bazuara në informacionin nga plani i kablove dhe ngarkesat e parashikuara. Modelet dhe metodologjitë e përdorura për llogaritjen e niveleve të EMF janë testuar në mënyrë të përsëritur dhe janë gjetur të jenë shumë të sakta dhe të sigurt. Në këtë mënyrë, nivelet e EMF të llogaritura nga Exponent për këtë projekt janë të sakta dhe nuk pritet të ndryshojnë nga nivelet e fushës magnetike pas ndërtimit në kushte të ngjashme.

Pyetja: Ku mund të shihen skicat e ndërtimit?

Përgjigjja: Shoqëria është e vetëdijshme se Bashkia ka vendosur të mos bëjë publike skemat e detajuara për shkak të problemeve të sigurisë. Shoqëria synon të respektojë vendimin e Bashkisë në lidhje me këtë dhe, në këtë mënyrë, gjithashtu nuk do t'i vërë planet në dispozicion të publikut. Banorët mund të kontaktojnë drejtpërdrejt Bashkinë e Beverly ose Bashkinë e Salem për të kërkuar akses në plane.

Pyetja: Kur do të aplikoni për lejet nga Këshilli Bashkiak i Beverly? Çfarë plani keni nëse lejet nuk miratohen?

Përgjigjja: Shoqëria parashikon paraqitjen e aplikimit të saj për dhënien e lejes së ndërtimit në Këshillin Bashkiak menjëherë pas Vitit të Ri. Siç u përmend më lart, legjislacioni është i qartë sepse shërbimet komunale kanë të drejtë të ndërtojnë infrastrukturën brenda rrugëve publike dhe se Këshilli Bashkiak do të veprojë si agjent i Komonuelthit dhe jo si një organ vendor. Nëse Këshilli Bashkiak refuzon peticionin për ndonjë arsye, Shoqëria do të aplikojë në EFSB për një Certifikatë të Ndikimit Mjedisor dhe Interesit Publik, e cila, nëse jepet, do të kishte efektin ligjor të dhënies së GOL dhe çdo leje projekti shtesë të nevojshme për ndërtimin e projektit.

Pyetja: A do të ketë një heqje të konsiderueshme të pemëve përgjatë anës së Cross Lane që i afrohet rezervatit natyror të Sally Mulligan?

Përgjigjja: Planet aktuale të ndërtimit nuk pritet të kenë ndikim në rreshtimin e pemëve në Cross Lane.

